



POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

- 1

Kur Jeronim de Rada shkruante "Milosaon" në vitin 1836
- 2

Nuk ndalet rritja e çmimeve të apartamenteve në Tiranë
- 3

'Plasa së qari dhe ndërpreva emisionin', përletet Sonila Meço: Kam komunikuar me zëra që nuk jetonin më...Rrëfimi pikant i gazetares në emisionin N'kohë!
- 4

Vjedhje energjie, armë dhe drogë, Policia e Tiranës arreston 6 persona, mes tyre 3 punonjës të OSHEE
- 5

18 vjeçari që vrau 2 persona u shpall i pafajshëm, Biden reagon i mërziut: Por duhet t'i bindemi verdiktit

Kronikë

## Shpërndanin kokainë në Tiranë, në pranga dy vëllezërit! Arrestohet edhe një 39-vjeçar, i kamufluar si taksist shiste drogë nëpër kryeqytet

Policia e Tiranës ka arrestuar tre shtetas që posedonin dhe shpërndanin lëndë narkotike në kryeqytet, dy prej tyre vëllezër. Blutë e Tiranës sekuestruan kokainë dhe cannabis sativa, të ndarë në doza, gati për shitje gjatë operacionit të koduar "Braka"



Redaksia

16 Nëntor, 13:56 | Përditësimi i fundit: 16 Nëntor, 14:38



Policia e Tiranës ka arrestuar tre shtetas që posedonin dhe shpërndanin lëndë narkotike në kryeqytet, dy prej tyre vëllezër. Blutë e Tiranës sekuestruan kokainë dhe cannabis sativa, të ndarë në doza, gati për shitje gjatë operacionit të koduar "Braka".

Sipas policisë u bë arrestimi në flagrancë i Griseld Halilaj, 25 vjeç dhe Arnold Halilaj, 20 vjeç (vëllezër) dhe sipas hetimeve, në bashkëpunim me njëri-tjetrin siguronin sasi të konsiderueshme të lëndës narkotike cannabis sativa dhe më pas e shisnin atë në doza të vogla, në zona të ndryshme të Tiranës.



LEXO EDHE:

Nuk ndalet rritja e çmimeve të apartamenteve në Tiranë



Gjatë kontrollit fizik iu gjet e iu sekuestrua në cilësinë e provës materiale lëndë e dyshuar cannabis sativa, 1 peshore elektronike, fishekë luftarakë, 1 dorezë metalike (përforcues grushti), dy aparate celularë, 1 patentë dhe kartë ID të dyshuara të falsifikuara.

Gjithashtu, u arrestua në flagrancë edhe shtetasi Erion Jasharllari, 39 vjeç, i cili merrej me shitje të lëndës narkotike të llojit kokainë në zona të ndryshme të Tiranës, duke e kamufluar aktivitetin e tij kriminal, me një mjet taksi që kishte në përdorim.

Gjatë kontrollit fizik nga shërbimet e policisë, këtij shtetasi iu gjetën doza me lëndë narkotike kokainë dhe një shumë parash, të cilat u sekuestruan në cilësinë e provës materiale bashkë me mjetin.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë së Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprat penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", "Falsifikimi i letërnjoftimeve, i vizave ose i pasaportave", "Mbajtja pa leje e armëve të ftohta" dhe "Mbajtja pa leje e municionit luftarak".

M.Q./K.T./Shqiptarja.com

TAG:

kokaine

Tirane

policia e tiranes

griseld halilaj

arnold halilaj

erion jasharllari

Komento



Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016



Sondazhi i ditës:

Ndëshkim për ndotësit e mjedisit. A duhet të aplikohen gjoba për ata që kanë përgjegjësi?

PO

JO

NUK KAM MENDIM

Lajme të tjera

Sociale



Bashkia e Tiranës rikthen pas 2 vitesh Natën e Bardhë! Veliaj: Tradita vazhdon... Më 29 Nëntor, 6 lokacione, 6 aktivitete

20 Nëntor, 21:09

Politikë



Dorëzohet blloku i parë i banesave të rindërtuara në Vaqarr! Rama: Do përfitojnë 33 mijë familje në total! Veliaj: Kjo zonë do jetë stacioni i Tiranës moderne

20 Nëntor, 17:10


Kronikë



Vjedhje energjie, armë dhe drogë, Policia e Tiranës arreston 6 persona, mes tyre 3 punonjës të OSHEE

20 Nëntor, 16:34


Kronikë



Me shpejtësi deri në 169 km në orë dhe të dehur në timon, vihen në pranga 4 shoferë në Tiranë, dhjetëra të tjerë gjobiten

20 Nëntor, 08:41

Pa kategori



Tentoi të grabisë një shtëpi në Tiranë, autori pikaset nga të zotët e shtëpisë, ia mbath me të katërtat

19 Nëntor, 23:01

Kronikë



'Mos më vrit, nuk dua të bëhem Engjëll', shkallët e Kryeministrit, vend homazhi për Mateon! Qindra qytetarë ndezin qirinj për vogëlushin 8-vjeçar

19 Nëntor, 20:18

Kodi Etik

Kontakt

Rreth Nesh

Raportoni Ju

